

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Ndihmoi me të dhëna sekrete Agasin, GJKKO lë në fuqi 'arrestin në shtëpi' për ish-kreun e SHISH! Në b urg 2 të tjerët, shefi i Policisë Shkencore i çoi Agasit ekspertizën e makinës - Shqiptarja.com
ADRESA	https://shqiptarja.com/lajm/informacione-sekrete-nw-duart-e-ergys-agasit-dhe-mesazhet-me-s-tyre-sot-masa-nw-gjkko-pwr-ishkreun-e-shish?r=kh0
BURIMI	shqiptarja.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	24 shtator 2026, 07:07:59 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	24 shtator 2026, 05:58:47 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e81e8c4c64652df7e1367ad6b5cd482ab771ed74bbedc8744f3149783eb42147
TEKSTI	8612807ddff719e49c75c88ea96e07d6517aa6c4d9e908efc77794c831fc1fe4
PAMJA	9899fdd23a775e319fe561519c6fa6a4b67889f28ecef7b9b9b6dc0b9fe75ba

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	0b2ac1e5d1e79426a836d496286c88f0ba80d54ae458c6c7639b57123c7f08e1
E MËPARSHMJA	4b9fbc51dbce3933511231b04003c38ec718e65d20a02bd19a95969d6f530500
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njëren nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/0b2ac1e5d1e79426a836d496286c88f0ba80d54ae458c6c7639b57123c7f08e1

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit



Pronari i 'Mira Mare' qëllon me shpulle shefin e policisë së Krujës, sherr pasi bëri manovra të rrezikshme në rrugë! Ofendime mes palëve

Kronikë

Ndihmoi me të dhëna sekrete Agasin, GJKKO lë në fuqi 'arrestin në shtëpi' për ish-kreun e SHISH! Në burg 2 të tjerët, shefi i Policisë Shkencore i çoi Agasit ekspertizën e makinës

Ish drejtoresha e SHISH, Vlora Hyseni, do të mbetet në arrest shtëpie, teksa hetimet për vijojnë si e dyshuar se i dha sekrete shtetërore Ergys Agasi dhe e ndihmoi në arrati. Hyseni nuk mbajti asnjë qëndrim në GJKKO. Më herët masat u konfirmuar edhe për shefin e Sektorit në Policinë Shkencore Kalluqi dhe kamerierin Sulejmani, të cilët u lanë në burg.

■ Kreu i SHISH: Agasin e rekrutova informator! SPAK: Alibi, të dhëna sekrete në makinën e biznesmenit!

■ Ish-kreu i SHISH nën akuzë se ndihmoi Agasin me të dhëna sekrete, Begaj do të mbledhë Këshillin e Sigurisë të hënën

■ Shkarkimi i Hysenit, Begaj takim me ministrin e Brendshëm, drejtorin e Policisë dhe kreun e komanduar të SHISH



Redaksia

24 Shtator, 07:53 | Përditësimi: 24 Shtator, 22:27

f Share Tweet

A A

TIRANË- Dy orë e gjysmë zgjati seanca në të cilën Gjykata e Posaçme la në fuqi masën e dhënë në mungesë arrest në shtëpi, për ish-drejtoreshën e Shërbimit Informativ Shtetëror, [Vlora Hyseni](#).

Ish-shefja e spiunazhit u paraqiti në [SPAK](#) e shoqëruar nga një makinë policie, në mesditë. Rreth orës 14:30, ajo la ambientet e gjykatës, e shoqëruar nga një efektive grua, për t'u dërguar në banesë, ku duhet të qëndrojë e mbyllur.

Njëjtë si për mediat jashtë, edhe brenda në [GJKKO](#) Vlora Hyseni, siç konfirmojnë burimet për Report Tv, nuk ka folur asnjë fjalë para gjyqtarës Flojera Davidhi, duke zgjedhur të mos japë sqarime në këtë fazë të procesit. Qëndrimet i mbajti avokati i saj Kastriot Selita, i cili kërkoi një masë më të lehtë sigurie se ajo e arrestit shtëpiak.



LEXO EDHE:

'Edi Rama duhet të arrestohet', Blushi: Përgjegjësia për SHISH nuk mbaron te drejtorët

Seanca zgjati rreth 2 orë e 30 minuta për shkak se mbrojtja ka kërkuar kohë të njohur me aktet e dosjes dhe provat mbi të cilat është mbështetur edhe gjykata për masën e arrestit.

Vlora Hyseni është person nën hetim, e dyshohet nga SPAK se ka ndihmuar biznesmenin [Ergys Agasi](#), edhe gjatë arratisë së tij 8 mujore, dhe i kanë vënë atij në dispozicion sekrete shtetërore.

Ajo është pyetur edhe përpara se gjykata t'i caktonte masën në mungesë, si person në dijeni. Më 18 shtator, Vlora Hyseni ka pretenduar se Ergys Agasi ishte bashkëpunëtor i saj në SHISH. Por, SPAK ka komunikime të vazhdueshme mes tyre, përfshirë biseda personale, e pretendon të kundërtën, se Agasi ishte furnizuar me informacione prej saj.

Ndërkohë, herët në mëngjes të enjten gjykata mbajti më vete seancën për Fatjon Kalluçin, shef në Laboratorin Shkencor të Policisë, dhe Embro Sulejmanin, kryekamerier në restorantin e vilave qeveritare në Durrës, u lanë në arrest në burg.

Efektivi [Fatjon Kalluqi](#) akuzohet për nxjerrje të sekretit shtetëror, dhe dyshohet se i ka dërguar Ergys Agasit në muajin gusht, para se të arrestohej, 3 foto të ekspertizës së makinës "Land Rover Defender" në pronësi të tij, që u sekuestrova gjatë kontrolleve në Equos Resort. Aty SPAK gjeti 9 faqe dokumente sekrete të SHISH. të cilat dyshohet se ia ka vënë në dispozicion Hyseni. Sic Agasi ka dëshmuar më



herët para hetuesve, ai i la me qëllim në mjet dokumentet sekrete, në mënyrë që SPAK t'i gjente gjatë kontrolleve.

Kryekamerieri Sulejmani, akuzohet për përkrahje të autorit të krimit, pasi gjatë arratisë i dërgonte Ergys Agasit ushqime në banesën ku qëndronte i fshehur, por edhe i rezervonte në lokal dhe ishte ai personi që kishte në dorë shërbimin për biznesmenin në kërkim. Vetë Sulejmani ka thënë se nuk e dinte se Agasi ishte person në kërkim.

Të dhënat janë zbuluar në **telefonin e sekuestruar** të Ergys Agasit, të cilin SPAK e akuzon për dosjen "Akshi".



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Kërkesi **Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, më datë 23.09.2026** ka paraqitur pranë gjykatës kërkesën për marrjen në pyetje të personit nën hetim **Vlora Hyseni**, ndaj së cilës është caktuar masa e sigurimit "Arrest në shtëpi".
2. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjyqësor të përbërë nga gjyqtarja Flojera Davidhi, me vendimin nr. **69**, datë **24.09.2026** vendosi vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues "Arrest në shtëpi", parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, ndaj personit nën hetim **Vlora Hyseni**.
3. Gjithashtu, gjykata, bazuar në nenin 103 të K.Pr.Penale ka vendosur ndalimin e publikimit tërësisht apo pjesërisht të këtij vendimi gjyqësor deri në përfundim të hetimeve paraprake.

Tiranë, më datë 24.09.2026

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

Rruga "Jordan Misja" Nr.1, 1057 Tiranë; tel/fax 0422225075; gjykata.gov.al

Vendimi i GJKKO

Share

Sqarim: Çdo person prezumohet i pafajshëm deri sa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë

Ora 14:35

Dy orë në GJKKO/ Ish-kreu i SHISH, Vlora Hyseni del nga gjykata pa thënë asnjë fjalë (VIDEO)

Vlora Hyseni, qëndroi 2 orë në GJKKO në seancën për vlerësim e masës së sigurisë. Ish-drejtoresha e SHISH mësohet se nuk ka mbajtur asnjë qëndrim gjatë seancës. Ndërsa edhe pasi doli nga Gjykata, ku iu konfirmua masa e arrestit shtëpiak, ajo nuk bëri asnjë koment për gazetarët.

SLE./Shqiptarja.com

f Share

P.J/Xh.K/Shqiptarja.com

TAG: vlora hyseni ergys agasi hetimet per grupin e agasit spak GJKKO Fatjon Kalluci Embro Sulejmani

Sa e vlerësoni këtë artikull? ★ ★ ★ ★ ★ ★ ★ ★ 3.3 / 5 (8 vlerësime)

LAJMET MË TË VLERËSUARA

Komente

Komento

© Ndalohej rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH
COM**Sondazhi i ditës:** Arrestimet e fundit nga SPAK, a janë provë e pavarësisë nga politika?

22 Shtator, 16:08

Po Jo Disi

Lajme të tjera



Arresti i ish-kreut të SHISH, të hënë në mbledhjet e Këshilli i Sigurisë Kombëtare! PD: Socialistët mbrojnë Hysenin! PS: Përgjegjësia personale

25 Shtator, 14:39



Eksperti rrëzon alibinë e Hysenit për Agasin: Kreu i SHISH s'mban kontakte direkte me informatorë, ja si mund ta verifikojë SPAK! Audit për informacionet e rrjedhura

25 Shtator, 14:06



Mediat: SPAK do marrë në pyetje dhe kreun e sapo komanduar të SHISH dhe drejtorin e operacioneve! 'U kapën duke fshirë serverët e SHISH?!'

25 Shtator, 13:43



Territorialja, Këshilli i Tiranës kërkon Veliajn në mbledhjen e 29 shtatorit! Shkresë SPAK dhe Buraieve: Leioieni



Begaj mbledh të hënë Këshillin e Sigurisë Kombëtare, Bardhi: Spektakël institucional! Të iaohë lloqari për



Debat për Vlora Hysenin në Komision/ Zhupa: Krerët e institucioneve në shërbim të krimit! Malaj: Përdieciësia penale

fizikisht ose me videokonferencë

25 Shtator, 13:34



Hyseni aludoi për lidhje të Klodiana Lalës me agjentë serbë, deputetja e PS: SPAK ta trajtojë me përparësi kallëzimin e gazetares! Mbrojtja e tyre kusht për demokracinë

25 Shtator, 11:36

emërimin e Viora Hysenit në krye të SHISH

25 Shtator, 13:19



U ekstradua nga Italia dy ditë më parë, GJKKO lë në burg anëtarin e 'Visit të Pojës'



Ketil Banushi

25 Shtator, 11:05

është individuale (VIDEO)

25 Shtator, 12:30



Thoma Gëllçi: Kush e çoi Viora Hysenin në krye të SHISH-it?



Thoma Gëllçi

25 Shtator, 09:58



Ish-kreu i SHISH nën akuzë nga SPAK se ndihmoi Agasin me të dhëna sekrete, Muçi për Report Tv: Rama të mbajë përgjegjësi politike, shteti ka rënë

25 Shtator, 09:49



Mero Baze: Rikthimi i SHISH-it në politikë si banalitet



Mero Baze

25 Shtator, 06:57



Spahiu: Gjermania, SHBA, Franca dhe Spanja asnjëherë s'kanë pasur grua në krye të Shërbimit Sekret

24 Shtator, 22:56

Kodi Etik

Kontakt

Rreth Nesh

Raportoni Ju

Puno me ne

[Shqiptarja.com]

Kërko

© 2011 - 2026 Shqiptarja.com - Ndalohej riprodhimi i paautorizuar i kësaj faqeje

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.